

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Nëntor 2021


**Tiranë, më 22 Dhjetor 2021:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2021, janë 548.819. Krahasuar me Nëntor 2020, ky tregues rezulton me një rritje 52,3 %. Në Nëntor 2021, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 244.061. Krahasuar me Nëntor 2020, ky numër është rritur me 64,5 %.

### Hyrjet e shtetasve

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë njëmbëdhjetëmujorit të 2021, është 5.421.177, duke u rritur me 2,2 herë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.1).

Përgjatë njëmbëdhjetëmujorit të 2021, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe me 4,6 herë dhe Spanja me 4,5 herë, ndërsa Greqia ka pasur rritjen më të ulët me 22,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Për publikim 22/12/2021**

### Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2021, janë 593.000 duke shënuar një rritje me 61,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2021, janë 313.058. Krahasuar me Nëntor 2020, ky numër është rritur me 50,4 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2021, janë 279.942. Krahasuar me Nëntor 2020, ky numër është rritur me 77,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë njëmbëdhjetëmujorit të 2021, është 3.847.877. Ky tregues është rritur me 43,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Nëntor 2020	Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2021
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>360.343</b>	<b>548.819</b>	<b>4.976.451</b>	<b>8.949.184</b>
Shqiptarë	211.981	304.758	2.499.448	3.528.007
Të Huaj	148.362	244.061	2.477.003	5.421.177
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>366.335</b>	<b>593.000</b>	<b>5.172.221</b>	<b>8.999.930</b>
Shqiptarë	208.183	313.058	2.691.130	3.847.877
Të Huaj	158.152	279.942	2.481.091	5.152.053

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Nëntor 2020	Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2021
Kosovë	69.942	90.896	1.293.712	2.561.191
Maqedonia e Veriut	28.558	26.327	338.309	528.475
Greqi	4.401	26.407	197.731	242.092
Itali	6.679	22.505	113.841	322.873
Angli	2.255	5.288	49.553	81.288
Mali i zi	19.987	27.644	155.487	294.138
Poloni	132	1.155	24.087	111.475
SHBA	1.739	4.271	22.500	90.854
Spanjë	68	616	2.613	11.692
Gjermani	1.151	4.641	36.209	113.564
Zvicër	882	1.369	14.922	54.162
Të tjera	12.568	32.942	228.039	1.009.373
<b>Gjithsej</b>	<b>148.362</b>	<b>244.061</b>	<b>2.477.003</b>	<b>5.421.177</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Nëntor 2020	Nëntor 2021	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2021
Hyrje Shtetas të Huaj	148.362	244.061	2.477.003	5.421.177
I. Personale	137.758	235.380	2.372.332	5.329.914
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	133.417	224.821	2.303.861	5.168.790
2. Qëllime fetare	51	46	298	634
3.Udhëtarë transit	4.290	10.513	68.173	160.490
II. Biznes dhe profesionale	10.604	8.681	104.671	91.263

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Nëntor 2020	34.580	15.054	310.709	36.007	10.031	320.297
Nëntor 2021	109.150	20.797	418.872	119.837	17.308	455.855
Janar-Nëntor 2020	606.651	204.872	4.164.928	615.295	213.324	4.343.602
Janar-Nëntor 2021	1.304.348	447.390	7.197.446	1.327.332	429.054	7.243.544

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika\\_e\\_Revizionimit\\_Statistikor](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor).

**Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistrojnë shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.